



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCEVE VENDORE

3977
Nr. Prot.

Tiranë, më 26.03.2024

Lënda: Dërgohen mendimet mbi raportin vjetor të monitorimit të buxhetit 2023

Kryetar i Bashkisë DIJAKE

Kryetar i Këshillit të Qarkut _____

Në zbatim të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" të ndryshuar" dhe të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", bashkëlidhur ju dërgojmë komentet dhe rekomandimet e Ministrisë së Financave mbi raportin vjetor të monitorimit të buxhetit të vitit 2023, për njësinë tuaj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITËSHËM



KOMENTE TË PËRGJITHSHME
Raporti i monitorimit të buxhetit vjetor 2023
Bashkia DIVJAKË

1. Vlerësim i Përgjithshëm

Monitorimi, është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Proceset e monitorimit të zbatimit të buxhetit, si pjesë përbërëse e procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor janë të unifikuara nga kuadri ligjor dhe nënligjor për financat e vetëqeverisjes vendore. Për NJVQV-të monitorimi mbështetet në Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”. Mirëmenaxhimi i financave vendore është i rëndësishëm me qëllim realizimin e produkteve të parashikuara, brenda limitit të miratuar të shpenzimeve për çdo program. Përmes të dhënave të raportuara në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit është e rëndësishme që të sigurohet informacion i saktë dhe i plotë në lidhje me performancën e shpenzimeve dhe realizimin e produkteve. Monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fordet përkatëse të planifikuara për përmbushjen e tyre.

Bashkia Divjakë e ka dorëzuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor 2023, në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 1441 Prot., datë 29.02.2024, brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar. Raporti i monitorimit i bashkisë Divjakë është paraqitur në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore” me relacionin shoqërues, anekset 1 dhe 2, për realizimin e shpenzimeve sipas programeve dhe llogarive ekonomike, anekset 3 dhe 4 për realizimin e treguesve të performancës/ produkteve të programit dhe realizimi i objektivave të politikës së programit, aneksi 5 për realizimin e investimeve, treguesit financiarë dhe informacionin për detyrimet e prapambetura. Vlerësojmë punën e bërë nga bashkia Divjakë për hartimin e relacionit shpjegues dhe anekseve shoqëruese të raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor 2023, ku konstatohet puna e mirë për plotësimin e së tyre, si edhe informacion lidhur me aktivitetet e kësaj bashkie për çdo program

2. Karakteristikat kryesore të të ardhurave dhe shpenzimeve

• Të ardhurat

Për vitin 2023, Bashkia Divjakë ka paraqitur një pasqyrë të detajuar të planit të të ardhurave sipas burimit dhe nivelit të realizimit për secilin zë. Bashkia Divjakë ka realizuar të ardhurat nga burimet e veta në masën 157 milion lekë, nga 230 milion lekë të planifikuara, pra ka realizuar faktikisht rreth 68 % të vlerës së planifikuar për vitin 2023 ose rreth 73 milion lekë më pak se planifikimi. Nga të dhënat del se krahasuar me vitin 2022 bashkia Divjakë ka arritur të sigurojë dhe rreth 14 milion lekë më shumë të ardhura se viti i kaluar. Realizimin më të madh e ka pasur zëri i të ardhurave nga tarifat vendore me 82 % të planit, ndërkohë të ardhurat me peshën më të madhe në buxhetin e bashkisë Divjakë janë të ardhurat nga taksat vendore me rreth 68% realizim

ku përqindjen më të lartë të realizimit e ka tatimi mbi të ardhurat personale, taksat e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, kurse nga tarifat, ajo e menaxhimit të mbetjeve urbane.

- **Shpenzimet**

Bazuar në të dhënat e aneksit 1 të raportit të monitorimit rezulton se Bashkia Divjakë, për vitin 2023 ka planifikuar shpenzime në masën 715.6 milion lekë dhe i ka realizuar ato për rreth 534.1 milion lekë ose rreth 75%. Kjo bashki administron dhe menaxhon fondet publike sipas 15 programeve buxhetore të miratuara, ku në tabelën e mëposhtme jepet sipas çdo programi, plani i viti 2023 në mijë lekë, realizimi faktik në mijë lekë, përqindja e realizimit faktik kundrejt planifikimit dhe pesha në përqindje që zë secili program buxhetor kundrejt totalit të planifikuar dhe atij faktik:

Titulli	Emërtimi i Programit	Plan 2023	Fakt 2023	% e realizimit	Pesha në % (plani)	Pesha në % (fakti)
01110	Planifikim menaxhim administrim	312,786.3	227,214.7	72.6%	43.7%	42.5%
03140	Shërbimet e policisë vendore	6,968.0	6,042.9	86.7%	1.0%	1.1%
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi	24,060.2	16,193.1	67.3%	3.4%	3.0%
04130	Mbështetja për zhvillim ekonomik	20,627.2	13,337.2	64.7%	2.9%	2.5%
04240	Menaxh, infrastrukturës ujitje kullim	34,223.8	29,228.0	85.4%	4.8%	5.5%
04260	Administrim pyje kullota	1,521.5	938.8	61.7%	0.2%	0.2%
04520	Rrjeti rrugor rural	73,929.3	54,757.4	74.1%	10.3%	10.3%
04980	Fondi rezerve	6,590.0	0.0	0.0%	0.0%	0.0%
05100	Menaxhimi i mbetjeve	4,000.0	3,122.3	78.1%	0.6%	0.6%
06260	Shërbimet publike vendore	117,085.7	101,645.5	86.8%	16.4%	19.0%
08130	Sport dhe argetim	2,235.8	0.0	0.0%	0.3%	0.0%
08140	Zhvillimi i Sportit (Palestër e mbuluar)	17,376.2	11,805.0	67.9%	2.4%	2.2%
08220	Trashëgimia kulturore dhe artistike	1,967.7	993.5	50.5%	0.3%	0.2%
09120	Arsimi parashkollor dhe bazë	82,441.2	65,446.7	79.4%	11.5%	12.3%
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	7,796.0	1,355.0	17.4%	1.1%	0.3%
10430	Perkujdesi social	2,030.0	2,030.0	100.0%	0.3%	0.4%
	TOTAL	715,638.8	534,110.2	74.6%	100.3%	100.0%

Në lidhje me të dhënat e mësipërme vërejmë se si plani ashtu edhe fakti i raportuar nga bashkia në raportin e monitorimit për vitin 2023, përputhen plotësisht me të dhënat e sistemit të thesarit. *Raportimi për programet duhet bërë si në strukturë dhe në kodifikim në përputhje me përcaktimet e udhëzimit standard të PBA-së, shtojca1.* Mbështetur mbi programet e mësipërme të raportuara, bashkia Divjakë ka organizuar ndarjen e shpenzimeve buxhetore me qëllim financimin e plotë të të gjitha kompetencave dhe shërbimeve ndaj qytetarëve që ofron kjo NJVQV. Bashkia Divjakë, pothuajse i ka raportuar programet në kodifikim në përputhje me përcaktimet e udhëzimit standard të PBA-së, shtojca1, përveç programit 08140 “Zhvillimi i sportit” ku evidentohet një projekt investimi me emërtimin “Ndërtim palestere mbuluar dhe rikonstruksion”. *Mbështetur në udhëzimin standard të PBA-së, ndarja e shpenzimeve duhet realizuar sipas 20 programeve buxhetore të përcaktuara në shtojcën 1.*

Referuar të dhënave të mësipërme në aneksin 1 evidentohet se në total realizimi i shpenzimeve është 75% e planit të buxhetit vjetor. Kjo përqindje realizimi pasqyrohet edhe tek realizimi faktik i programeve ku vërehet se thuhet një pjesë e madhe e programeve kanë një realizim faktik nga 61-87%, përveç programit 08220 me 50.5%, programit 08130 që nuk ka realizim dhe 09230 “Arsimi mesëm i përgjithshëm” me 17.4% realizim.

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga bashkia Divjakë dhe gjeneruar nga sistemi thesarit, situata për realizimin e zërave buxhetorë sipas logarive ekonomike për këtë bashki paraqitet si më poshtë në mijë lekë:

	Emërtimi	Plan 2023	Fakti 2023	% e realizimit	Pesha në %
1	Shpenzime Personeli (600+601)	362,218	323,131	89.2%	60.5%
2	Shpenzime Operative (602)	216,873	122,934	56.7%	23.0%
3	Shpenzime të tjera korente (604-606)	13 641	0	0.0%	0.0%
4	Shpenzime Kapitale (230-231)	122,906	88,045	71.6%	16.5%
	TOTALI	715,639	534,110	74.6%	100.0%

Siç konstatohet nga të dhënat, zëri me përqindjen më të lartë të realizimit është Shpenzime personeli me 89.2 % të realizimit faktik krahasuar me planin për buxhetin vjetor 2023, ndërkohë që realizimi i shpenzimeve operative është rreth 57% dhe realizimi për shpenzimet kapitale paraqitet në 71.6 % të planit vjetor. Sa i përket peshës që zënë secili nga zërat buxhetorë vërehet se zëri shpenzime personeli është edhe zëri me peshën më të madhe në buxhetin vjetor të bashkisë Divjakë me rreth 60.5% të buxhetit faktik vjetor, më pas janë shpenzimet operative me rreth 23% dhe shpenzimet kapitale që zënë rreth 16.5%. *Rekomandohet të punohet në drejtim të ndryshimit të këtyre raporteve, pasi rezultojnë që një pjesë e madhe e buxhetit të bashkisë Divjakë shkon për shpenzime personeli, ndërkohë që një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve sugjerohet ta zënë shpenzimet për investime.*

Në raportin e monitorimit të bashkisë Divjakë është raportuar gjithashtu në mënyrë të detajuar edhe për programet që financohen nga transfertat e kushtëzuara dhe fondet e deleguara për të cilat bashkisë Divjakë i janë akorduar si plan rreth 283.7 milionë lekë që janë realizuar në masën rreth 276.2 milion lekë ose 97.3%

- **Projektet e investimeve**

Bashkia Divjakë e ka bërë raportimin e listës së investimeve në përputhje me kërkesat e aneksit 5, të Udhëzimit standard për monitorimin e zbatimit të buxhetit. Janë paraqitur të dhëna lidhur me realizimin e periudhës aktuale dhe realizimin progresiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale bashkëngjitur dhe me komentet për ecurinë e projekteve, e po ashtu janë dhënë argumenta lidhur me performancën, ecurinë, masat e realizimit si dhe faktorëve që kanë ndikuar në realizim/mosrealizimin e tyre. Gjithashtu konstatohet fakti që gjatë vitit 2023 bashkia Divjakë ka mbështetur një numër të konsiderueshëm investimesh me financim të brendshëm disa prej të cilave të realizuara e disa të tjera në proces realizimi.

3. Treguesit e performancës/ produktet

Në raportin e monitorimit të dorëzuar nga bashkia Divjakë konstatohet se janë plotësuar aneksi 3 dhe 4 për raportimin e treguesve të performancës/ produkteve të programit dhe raportin e realizimit të objektivave të politikës së programit, për çdo program. Në këtë drejtim vlerësojmë punën e bërë nga bashkia Divjakë dhe inkurajojmë monitorimin e realizimit të produkteve buxhetore në përputhje të plotë me planifikimin buxhetor afatmesëm.

4. Treguesit financiarë

Paraqitja e informacionit mbi treguesit financiar është i domosdoshëm për të bërë të mundur vlerësimin e qëndrueshmërisë financiare të njësisë vendore, marrjes së informacionit në lidhje

me prioritetet e njësisë, burimeve në dispozicion, mënyrën e përdorimit të fondeve publike të njësisë, si dhe sa ruhet disiplina fiskale dhe nëse njësia është e ekspozuar ndaj risqeve fiskale të cilat kërkojnë një vëmendje të veçantë nëse konstatohet se janë prezent.

Bashkia Divjakë ka raportuar treguesit financiarë sipas kërkesave të shtojcës 5 të Udhëzimit standard nr.22 datë 30.07.2018. Nga të dhënat për këtë pjesë konstatohet se raport i shpenzimeve të përgjithshme ndaj të ardhurave të përgjithshme është në masën rreth 75%; raporti i të ardhurave të veta ndaj të ardhurave të përgjithshme është 19% që tregon se kjo bashki varë: së shumti nga transfertat e buxhetit qëndror; raporti i shpenzimeve për investime kapitale ndaj shpenzimeve të përgjithshme paraqitet në masën 16% apo shpenzimet e personelit kundrejt shpenzimeve të përgjithshme të cilat janë në masën 62%.

5. Informacion mbi detyrimet e prapambetura

Vërejmë se bashkia Divjakë në raportin e monitorimi ka konstatuar se deri në fund të dhjetorit 2023, ka gjendje detyrime financiare të papaguara në vlerën 7,003 mijë lekë, një vlerë relativisht e ulët më rreth 1.3% e shpenzimeve faktike dhe me ulje të konsiderueshme nga viti i kaluar. Në këtë kuadër vlerësojmë maksimalisht punën e bërë nga bashkia Divjakë në këtë drejtim pasi *trajtimi i detyrimeve të prapambetura, hartimi dhe ndjekja me përpikmëri e planit të shlyerjes dhe mos krijimi i detyrimeve të reja duhet të konsiderohet prioritet për njësinë e vetëqeverisjes vendore.*

6. Komente të tjera dhe rekomandime

- Informacioni i përcjellë nga Bashkia Divjakë është paraqitur në përputhje të plotë sipas kërkesave të anekseve të Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”. Në këtë kuadër vlerësojmë punën e bërë nga bashkia në plotësimin e kërkesave të udhëzimit standard të monitorimit duke plotësuar tabelat, anekset dhe relacionin shoqërues, madje duke përfshirë në raportin e monitorimit edhe informacion të detajuar lidhur me aktivitetet e kësaj bashkie të kryera për çdo program.
- Rekomandojmë që monitorimi i realizimit të produkteve të realizuara për secilin program buxhetor të konvergojë dhe të jetë në përputhje të plotë me planifikimin buxhetor afatmesëm.
- Vlerësojmë që raportimi lidhur me detyrimet e prapambetura të është i barabartë me vlerat e gjeneruara në sistemin e thesarit, dhe vlera e tyre për bashkinë Divjakë ka ardhur në ulje të konsiderueshme
- Rekomandojmë publikimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2023, në faqen zyrtare të bashkisë në internet, në kuadër të transparencës si dhe në zbatim të nenit 48, pika 3, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” të ndryshuar.